

**ARDIAN MUHAJ**

**PROJEKTE KUNDËROSMANE NË SHEK. XVI-XVII  
MES FANTAZISË, INTERESIT DHE REALITETIT**

Projektet e popullsive nën sundimin osman për çlirim nuk mund të shihen të shkëputura nga masat e vetë pushtetit për t'u mbrojtur nga revoltat dhe kryengritjet e ndryshme. Për osmanët, ashtu sikurse për çdo pushtet politik, vetëruajtja dhe vazhdimësia ishte shqetësimi kryesor. Edhe përpjekjet që minonin stabilitetin e këtij pushteti trajtoheshin me përparësinë më të madhe. Sfida ndaj pushtetit herë vinte nga brenda vetë shtetit, dhe herë të tjera brenda pushtetit osman. Në këtë aspekt mund të flitet për kryengritje kur kundërshtia ndaj pushtetit vinte nga zonat dhe popullsitë e ndryshme të shtetit osman dhe për "fitne" kur sfida zanafillonte nga aktorët e shtresës së pushtetarëve. Kufiri mes këtyre dy shprehjeve të kundërshtisë politike nuk ishte i prerë qartë. Për shembull, tërheqja në malet e Moldavisë e kryekomandantit të ushtrisë osmane shqiptarit Ferhat Pasha në krye të 4 mijë shqiptarëve, kur merr vesh se ishte dënuar me vdekje është e vështirë të interpretohet si kryengritje.<sup>1</sup> Ky cikël ndërkëmbimi mes rebelimit apo *fitnes* dhe qetësisë pasqyrohet në kronikat osmane në të cilat *fitneja* konsiderohet si një nga krimet më të urryera.

Nga ana tjetër dallimi mes *fitnes* dhe kryengritjes bëhej edhe më i vështirë për t'u shquar për faktin se një pjesë e madhe e vrullit kundërshtues ndaj pushtetit qendror u mor në dorë dhe u përqendrua tek sundimtarët ose qeveritarët lokalë nëpër provinca. Ky forcim i rolit politik të këtyre qeveritarëve vendorë kishte si bazë fuqizimin ekonomik të tyre për shkak të transferimit gjithnjë e më të madh të taksave dhe përgjegjësisive nga pushteti qendror tek ai vendor, sidomos duke nisur nga gjysma e dytë e shek. XVII. Këta pushtetarë vendorë mblodhën rreth vetes forca ushtarake në përputhje me fuqinë ekonomike dhe me

<sup>1</sup> *Dokumente të shekujve XV-XVII për historinë e Shqipërisë*, vëllimi II (1593-1602), përg. Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1990, dok. nr. 26, 19 gusht 1595; dok. nr. 27, 2 shtator 1595.

pushtetin e tyre. Këto forca ushtarake vendore gjithashtu shërbyen si përthithës të energjisë kundërshtuese.

Si çdo rast i ngjashëm i kohës edhe struktura e negocimi i pushtetit në trojet shqiptare ka pësuar evoluim gjatë shekujve në shqyrtim. Kjo i detyrohet disa faktorëve: së pari, ka të bëjë me evoluimin e vetë pushtetit qendror; së dyti, me dinamikën e zhvillimit të shoqërisë në trojet shqiptare; së treti, me evoluimin e ekuilibrave ndërkombëtarë. Ndërthurja e këtyre faktorëve dhe jo vetëm ka rezultuar në diferencimin e situatës në aspektin kronologjik dhe hapësinor. Në aspektin kronologjik, fuqia e agjencisë lokale ka evoluar në mënyrë lineare dhe pothuajse graduale nga shekulli i pushtimit apo depërtimit osman deri në shekullin e autonomizimit të aktorëve politikë shqiptarë dhe përfundon me shekullin e rikthimit të ushtrimit të drejtpërdrejtë të pushtetit perandorak pa ndërmjetësimin e aktorëve lokalë.

Kronikat e kohës dëshmojnë që herët këtë përpjekje të sundimtarëve lokalë të bregut shqiptar për t'u faktorizuar në jetën politike e tregtare të Adriatikut të kohës.<sup>2</sup> Procesi i avancimit të statusit faktik të shqiptarëve në kuadër të Perandorisë arriti kulmimin me pashallëqet autonomiste të fillimshkullit XIX. Ky proces mund të ndiqet me qartësi në sanxhakun e Shkodrës, ku në fundin e shek. XVII familja e Bushatlinjve që në vitet 1690 udhëhiqej nga Sulejman Pasha e mbante postin e sanxhakbeut praktikisht si të trashëgueshëm.<sup>3</sup>

Në këndvështrimin e fuqive politike të huaja, çlirimi i shqiptarëve nga sundimi politik osman ishte i njëkohshëm që në shek. XIV-XV me shtrirjen e sundimit të tyre mbi shqiptarët. Në këtë aspekt duhet parë prehistoria e traditës që e degëzon këndvështrimin mbi çlirimin në varësi të grupeve të përfshira. Për vendasit shqiptarë, çlirimi nga osmanët, mund të ketë nënkuptuar mosrënien nën një pushtim apo sundim të ri edhe pse mundësitë e realizimit mbetën të pakta e të kufizuara në kohë e hapësirë. Nga ana tjetër, nga pozicioni i interesave të fuqive të huaja që konkurronin për pushtet politik mbi shqiptarët, çlirimi i shqiptarëve nga

<sup>2</sup> Në Senatin e Venedikut paraqitet një i dërguar i sanxhakbeut të Vlorës. *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë*, vëll. IV (1479-1506), Pjesa I (1479-1499), përgatitur nga Injac Zamputi, Universiteti i Tiranës, Tiranë: 1967, dok. nr. 37, gusht 1479.

<sup>3</sup> Evliya Celebi më 1662, pohon se qeveritarët trashëgimtarë vinin nga fshati i Bushatit. Robert Dankoff & Robert Elsie, *Evliya Qelebi, in Albania and Adjacent Regions (Kosovo Montenegro, Ohrid)*, Leiden: E.J. Brill, 2000, f. 29, 31.

sundimi osman nënkuptonte vendosjen e shqiptarëve nën sundimin e tyre, qoftë ky venedikas, austriak apo spanjoll.

Kjo natyrisht ka sjellë njëfarë konfuzioni në ndarjen qartë të asaj, që është nismë e shqiptarëve, nga ato që ishin nisma për interesa të të huajve. Shpesh është anashkaluar kjo dhe është konsideruar çdo përpjekje antiosmane në territoret e banuara nga shqiptarët si vetvetiu pro-shqiptare, gjë e cila është e pasaktë.

Nga ana tjetër, ky brendashkrim apo shtojcëzim i interesave të shqiptarëve brenda interesave të shteteve të huaja në rivalitet me shtetin osman e pamundëson ndjekjen dhe kuptimin e dinamikës së situatës. Ka një numër traktatesh, planesh e projektesh të shteteve të huaja të interesuara për shtrirjen e sundimit të tyre në territoret shqiptare, por dinamika e hartimit të tyre është e lidhur ngushtë me dinamikën e marrëdhënieve mes këtyre shteteve dhe shtetit osman.

Në këtë trekëndësh apo marrëdhënie tripalëshe elementi shqiptar sakrifikohet dhe nënkuptohet por pa u kuptur dhe kontekstualizuar qartë. Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se sa herë që shtetet e huaja ishin në konflikt me osmanët, projekte të tilla shtoheshin dhe aktivizoheshin pavarësisht elementit shqiptar. Rikthimi i paqes mes tyre sillte edhe zbehjen dhe braktisjen e projekteve të tilla dhe sërish kjo paqe mes shteteve të huaja rivale nuk pasqyronte situatën reale të raporteve mes shqiptarëve dhe osmanëve.

Pra, dinamika dhe ritmi i përpjekjeve antiosmane në përgjithësi qëndronte në lidhje të ngushtë me situatën ndërkombëtare dhe me ndikimin e saj në territoret shqiptare. Rivendosja e paqes mes Venedikut dhe osmanëve do të sillte medoemos edhe rënien e ritmit dhe energjisë së përpjekjeve kundërosmane lokale. Kjo nuk do të thotë se këto përpjekje ishin një aneks i politikave të shteteve të huaja, por më së pari, që tek shtetet e tilla këto përpjekje gjenin një mbështetje jetike. Në këtë aspekt, venedikasin ishin aktorët më të rëndësishëm që mund të nxisnin ose shuanin përpjekjet lokale. Dukja e paqes në horizont shoqërohej edhe me vigjilencë të shtuar të autoriteteve venedikase në mënyrë që popullsitë nën ndikimin e tyre të frenoheshin në kohë, për të mos prishur paqen.<sup>4</sup> Në

---

<sup>4</sup> Proveditori i përgjithshëm venedikas i shkruan Senatit për sa është duke vepruar për të mbajtur në bindje popullsitë e Nikshiqit dhe të viseve të tjera, ashtu edhe për shpenzimet e nevojshme. *Archivio di Stato di Venezia* (më tej: ASV), Senato III, Secreta. Dalmazia f. 130; *Il Montenegro da relazioni dei provveditori veneti: (1687-*

përputhje me situatën e favorshme ndërkombëtare që krijonte mundësi për kundërshtim të pushtetit osman, që herët, në kulmin e luftës veneto-osmane të viteve 1463-1479 kemi një numër të madh raportesh, projektesh e planesh që parashikonin përfshirjen e popullsisë lokale në to.<sup>5</sup> Edhe pse popullsitë e kryengritura dhe të rebeluara sidomos në zonat kufitare, tentonin të vendosnin ose mbanin lidhje me fuqitë e huaja më të afërta, venedikase e spanjolle, në përgjithësi, kryengritja vendore i brendashkruhet një konflikti ndërkombëtar, konkretisht atij mes Venedikut dhe shtetit osman.

Mirëpo, kjo nuk duhet të na bëjë të mendojmë se këto ishin dinamikat dhe projektet e shqiptarëve. Kështu duhet bërë dallimi mes rastit kur të tjerët flasin për shqiptarët dhe kur vetë shqiptarët flasin për vete; kur të tjerët bëjnë plane për vete duke përfshirë territoret shqiptare, dhe kur shqiptarët i përjashtojnë. Edhe rastet e bashkëpunimit mes funksionarëve osmanë, shqiptarë ose jo për transferimin e pushtetit politik nga osmanët tek venedikasit apo spanjollët duhen parë si plane mbi shqiptarët, por jo medoemos për shqiptarët. Kështu brenda këtij rasti mund të përmendim atë të vitit 1483, kur dokumentohet një sugjerim i sanxhakbeut të Moresë i bërë venedikasve, që të përfitojnë nga rasti i volitshëm për të rimarrë Shqipërinë dhe provinca të tjera të Ballkanit.<sup>6</sup>

Një nga problemet që i shqetësonin popullsitë dhe që zbehte entuziazmin vendor për ndryshim të pushtetit politik ishte frika e braktisjes së befasishme të këtyre popullsive nga vetë nxitësit e mbështetësit e huaj. Kjo ishte e qartë edhe për vetë banorët që ishin përfshirë në konflikt. Kështu, edhe këta banorë për t'i dalë situatave përpara në rast të braktisjes së beftë nga venedikasit, përpiqeshin të siguronin sa më shumë vetveten nga kundërpërgjigjja osmane ose nga problemet që sillte riintegrimi i tyre në kuadër të sundimit osman. Veçanërisht, kjo ishte shqetësim për ato territore ku sundimi venedikas ishte shtrirë përkohësisht gjatë zhvillimit të luftës. Tërheqja venedikase krijonte pasigurinë e natyrshme që sjell ndërrimi i shpejtë i pushteteve. Kjo pasqyrohet më së miri në një dokument të majit të vitit 1699, ku

1735), a cura di Ferdinando Ongonia, Roma: Tip. Emiliana, 1896, f. 114, dok. nr. 230, 27 prill 1699.

<sup>5</sup> Pjesë dhe përmbledhje nga një paraqitje në gjuhën latine, në të cilën flitet për rrugët nëpër të cilat turqit mund të sulmohen. *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë ...*, IV/1, dok. nr. 46, viti 1479.

<sup>6</sup> *Po aty*, dok. nr. 91, 1 shkurt 1483.

thuhet se, krerët e vendeve malore që së fundi kanë qenë pushtuar prej venedikasve, janë në mëdyshje për të vendosur si duhet të veprojnë në rrethanat që janë krijuar, kur venedikasit, me anë të traktateve që po bëhen, do të mbajnë vetëm Kastelnovon e Rizanon, kurse vendet e tjera do t'u lihen turqve.<sup>7</sup> Akoma më qartë shprehet kjo mëdyshje në një dokument të qershorit të po atij viti ku thuhet se popullsitë malore që, në përpjekjet e fundit me ushtritë osmane kishin përkrahur venedikasit, dhe tani që flitej se do të bëhet paqja, shprehnin shqetësimin e tyre meqë dyshojnë se Venediku, kur të nënshkruaj paqen, do t'i braktisë duke ua lëshuar sundimtarëve osmanë vendet e tyre.<sup>8</sup> Këto shqetësime në fakt janë të dokumentuara gjerësisht dhe dëshmojnë se roli i tyre në përballjen veneto-osmane të radhës nuk ishte e pandjeshme.

Kjo pasiguri për të gjetur mbështetje të sigurtë qoftë tek spanjollët, qoftë tek venedikasit, e më vonë tek austriakët e rusët sillte një ndërgjegjësim të këtyre popullsive lokale mbi përkohshmërinë dhe paqëndrueshmërinë e mbështetjes së huaj. Kjo ishte një nga arsyet, pse, si krerët laikë, ashtu edhe krerët fetarë, tregoheshin të matur dhe hezitonin me të drejtë të përfshiheshin në projekte adventureske lokale apo të paqëndrueshme të huaja. Edhe vetë Papatë preferonte maturinë dhe vetëpërmbytjen më shumë se sa përfshirjen e klerikëve në projekte të tilla. Kështu, në gusht të vitit 1699, peshkopi i Zadrimës, Gjergj Teodori, i bënte një paraqitje të hollësishme Kongregacionit të Propaganda Fides mbi gjendjen e dioqezës së vet. Së pari, fliste për vuajtjet që kanë pësuar të gjithë gjatë luftës së fundit dhe pastaj se si sundimtarët janë hakmarrë ndaj atyre që kanë marrë pjesë në luftë, ku shumë veta «kanë paguar shumën të hollash për të shpëtuar nga vdekja».<sup>9</sup> Duke ia dërguar Romës relacionin e peshkopit të Zadrimës, kryepeshkopi i Tivarit, Vincent Zmajeviçi, lavdëron veprën e ipeshkvit të Zadrimës që është sjellë mirë

<sup>7</sup> ASV, Provved. Gener. Dalm. f. 131; *Il Montenegro da relazioni dei provveditori veneti* ..., f. 115, dok. nr. 231, maj 1699.

<sup>8</sup> *Il Montenegro da relazioni dei provveditori veneti* ..., f. 115-116, dok. nr. 232, 5 qershor 1699.

<sup>9</sup> *Archivio di Propaganda Fide* (më tej: APF), SC (Albania), vol. 5, f. 242rv; Peter Bartl, ed. *Quellen und Materialien zur Albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert: Aus dem Briefwechsel des Erzbischofs Vinzenz Zmajevic*, Wiesbaden: Otto Harrassowitz, 1975, I, f. 30-32, 5 gusht 1699.

gjatë luftës së fundit dhe tani turqit e respektojnë «sepse nuk është përzier, në të gjithë rrjedhën e luftës, në punët politike».<sup>10</sup>

Nga ana tjetër, nuk mungojnë edhe projektet e komplotet me kah të kundërt, ku funksionarë apo banorë vendas tentojnë të hartojnë apo të përfshihen në projekte që synojnë çlirimin e atyre zonave prej shteteve të tjera dhe kalimin apo pushtimin e tyre nga osmanët. Kështu, ndërkohë që në maj 1484 informohemi se Raguza kishte dërguar në Vlorë një anije për të mbledhur informata rreth përgatitjeve që osmanët bënin aty,<sup>11</sup> më 1486, mësojmë se në Raguzë ishte zbuluar një marrëveshje për t'ia dorëzuar vendin sulltanit.<sup>12</sup> Ndoqte që komplotistë të tillë, idealistë apo oportunistë nuk ishin të ndarë në etni, por bashkoheshin në plane të tilla në baza mbietnike. Këtë e ilustron rasti i verës së vitit 1484, kur rreth 170 persona, ndër të cilët shumë shqiptarë kishin bërë besëlidhje midis tyre duke sjellë galeren e Kristofor Duodos, aty ku ishte armiku.<sup>13</sup> Rasti më flagrant është ai që quhet në historiografi si Komploti i Kalabrisë, ku një numër i madh figurash kalabreze të udhëhequr nga filozofi Tomasso Campanella hartojnë planin e një kryengritjeje antispanjolle. Pjesë e rëndësishme e këtij projekti që synonte çlirimin e Kalabrisë nga sundimi spanjoll ishte thirrja në ndihmë e forcave osmane dhe vendosja e Kalabrisë nën suzerenitetin osman. Në këtë komplot ishin të përfshirë jo vetëm shqiptarë por edhe arbëreshë të Kalabrisë.<sup>14</sup>

Pra, ajo që bie në sy në të dy rastet, edhe kur popullsitë nën sundimin osman ngrinin krye, ashtu edhe në rastin e kundërt kur popullsitë nën sundimin venedikas apo spanjoll ngrinin krye e gjitha kjo nuk perceptohej si pavarësim nga pushteti i mëparshëm, por si ndërrim

<sup>10</sup> APF, SC (Albania), vol. 5, f. 241; P. Bartl, *Quellen und Materialien ...*, I, dok. nr. 2, f. 30, 4 shtator 1699.

<sup>11</sup> *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë ...*, IV/1, dok. 106, 7 maj 1484.

<sup>12</sup> *Po aty*, dok. 123, viti 1486.

<sup>13</sup> *Po aty*, dok. 107, 28 gusht 1484.

<sup>14</sup> Leen Sprult, "I processi campanelliani tra Padova e Calabria: documenti inediti dall'archivio dell'Inquisizione romana", in *Tommaso Campanella e la congiura di Calabria. Atti del Convegno di Stilo(18-19 novembre 1999) in occasione del IV Centenario della Congiura*, a cura di Germana Ernst, Comune di Stilo 2000; Luigi Amabile, *Fra Tommaso Campanella. La sua congiura, i suoi processi e la sua pazzia. Narrazione con molti documenti inediti politici e giudiziarii, con l'intero processo di eresia e 67 poesie di fra Tommaso finoggi ignorate*. Per, già Deputato al Palamento Nazionale, Napoli: cav. Antonio Morano editore, 1882, vol. 3, dok. 6-8, f. 14-17; *Archivo General de Simancas*, sección de Estado, legajo 1096.

pushtetesh apo transferim sovraniteti politik. Edhe propozimet e funksionarëve vendorë si klerikë ashtu edhe laikë nuk e shmangnin këtë çlirim, që prej tyre, shihej si transferim pushteti. Kjo veçanërisht vlen në rastin e klerikëve të cilët e shihnin vendosjen e pushtetit të një shteti të krishterë si çlirim nga sundimi mysliman. I tillë duhet parë projektpropozimi i Martin Segonit, ipeshkëv i Ulqinit, i paraqitur në Venedik për luftën kundër turqve.<sup>15</sup> Edhe projekte mbietnike apo tejshtetërore me origjinë nga vendet e krishtera duhen parë si të tilla, ku komponenti fetar shërben si shtysë e parë.<sup>16</sup>

Pas përfundimit të luftës së parë frontale mes Venedikut dhe osmanëve më 1479, politika e shtensionimit dhe tregtisë paqësore mes dy shteteve do të ndikonte edhe në situatën politike në Shqipëri. Duhet parë si një tërheqje e planifikuar dhe jo thjesht si rastësi zhvendosja e qendrës së rëndesës së Shqipërisë Venedikase nga territoret etnike shqiptare në kufijtë e këtyre territoreve. Kështu, menjëherë pas vitit 1479, Venediku ia kalon kontit të Kotorrit apelimet që më parë i shkonin kontit të Shkodrës.<sup>17</sup> Ajo që bie në sy këtu është se vendin e Shkodrës si kryeqendër e Shqipërisë Venedike nuk e mori as Durrësi që vazhdonte të ishte nën sundimin venedikas, as Ulqini dhe as Tivari. Kjo tërheqje kaq e madhe e Sinjorisë nga provinca e saj shqiptare padyshim që ndikoi në këtë aspekt.

Pjesë e kësaj përpjekjeje për ruajtjen e paqes dhe të ekuilibrave ishte edhe qarkullimi i forcave ushtarake vendase drejt fronteve apo destinacioneve të largëta, në përputhje me nevojat e strategjinë e venedikasve. Kjo e forconte më shumë varësinë e këtyre forcave nga politika e Sinjorisë dhe njëkohësisht e zbrazte në mënyrë të kontrolluar territorin nga elementët turbullues. Një problem tjetër në shtensionimin dhe rregullimet e pasluftës ishte çështja e veteranëve të luftës dhe çmobilizimi i forcave ushtarake. Menjëherë pas arritjes së paqes me osmanët, Senati i Venedikut vendosi të tërheqë nga vendet e Lindjes një mijë stratiotë për t'i shënuar në zotërimet venedike të tokës, kurse stratiotët e mbetur i shpërndau nëpër qytetet e zotërimit venedikas të

<sup>15</sup> *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë ...*, IV/1, dok. 116, para vitit 1486.

<sup>16</sup> Në një projekt për dëbimin e turqve, përveç rrugëve të tjera tokësore dhe detare, thuhet edhe se ushtritë evropiane mund të zbarkojnë në Vlorë. *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë ...*, IV/1, dok. 149, 25 mars 1490.

<sup>17</sup> *Po aty*, dok. nr. 23, 26 qershor 1479.

Lindjes.<sup>18</sup> Ky shtensionim dhe si rrjedhojë edhe çmobilizim i forcave ushtarake nuk pritej gjithnjë mirë nga luftëtarët për të cilët lufta ishte mënyrë dhe mjet jetese. Në More ku forcat stratiote ishin të konsiderueshme pati revoltë kundër venedikasve dhe një sërë dokumentesh flasin për çështjen e stratiotëve të rebeluar aty dhe rreth masave që venedikasit morën për ta vënë gjendjen nën kontroll.<sup>19</sup>

Vendosja e paqes mes dy fuqive nuk ishte e lehtë. Secila palë synonte të shfrytëzonte në mënyrë maksimale forcën e pozicionit ku ndodhej për të lidhur një paqe sa më të favorshme për të. Në këtë aspekt dy ishin elementët thelbësorë, rinegociimi i kufijve mes tyre dhe privilegjet tregtare që palët i njihnin njëri-tjetrit. Venediku mbajti në përgjithësi një qëndrim pragmatist ku ndërthureshin synimet ambicioze politike me ato tregtare që e bënte të nënshkruante traktate tregtie me Perandorinë Osmane. Kjo i lejonte Venedikut qasje të lirë pothuajse ekskluzive në zonën mesdhetare të sunduar nga osmanët.

Shkurajimi i shteteve të huaja ndaj lëvizjeve vendëse që konsideroheshin se prishnin marrëdhëniet ndërshtetërore merrte përmasa të dukshme dhe energjike kur ishte nevoja. Këto masa përfshinin sabotimin e lëvizjeve të tilla, kërkesat për të mos ngritur krye, e deri tek përndjekja, burgosja, vrasja, helmimi apo zhdukja e drejtuesve kryesorë, ose madje edhe shtypja me forca ushtarake e këtyre lëvizjeve. Një nga rastet e tilla është ajo e kryengritjes së Krokondil Kladës në Peloponez. Për të shuar këtë lëvizje që kërcënonte paqen e sapoarritur me osmanët, Senati i Venedikut shqyrtoi me urgjencë masat që duhen marrë në lidhje me kryengritjen. Madje, në janar të vitit 1481, Senati i shkruante sulltanit duke i treguar për masat e marra kundër Kladës, si garanci e vullnetit të mirë për paqe. Senati kishte ngarkuar ambasadorin dhe bajliun në Stamboll t'i paraqesin sulltanit keqardhjen e Republikës në lidhje me ngjarjet e Peloponezit.<sup>20</sup>

Kërkesat për mbështetje logjistike e politike të krerëve të rëndësishëm nuk merreshin parasysh dhe pasi shqyrtoheshin nga Senati mund të ndërmerreshin masa e hapa konkretë kundër tyre. Kjo krijoi që

<sup>18</sup> *Po aty*, dok. nr. 39, 15 shtator 1479.

<sup>19</sup> *Po aty*, dok. nr. 86, 15 shkurt 1482.

<sup>20</sup> *Po aty*, dok. nr. 65, 66, 67, 8 janar 1481.



herët pakënaqësi e mosbesim tek këta krerë lidhur me vendosmërinë e Sinjorisë në mbështetjen e përpjekjeve të tyre antiosmane.<sup>21</sup>

Kjo politikë e Venedikut nuk shkonte në një linjë me politikën dhe interesat e fuqive të tjera italiane, por edhe dalmate. Në kancelaritë e fuqive rivale madje qarkullonin edhe zëra mbi ndihmën që venedikasit u jepnin turqve.<sup>22</sup> Të tilla lajme mbi bashkëpunimin veneto-osman vinin nga burime të ndryshme dhe është e vështirë të hidhen poshtë si të sajuara. Ajo që duhet qartësuar është se kjo nuk përbënte kurrfarë skandali në atë kohë. Shtetet italiane ishin mjaft të ndara dhe në antagonizëm interesash për të tentuar gjithsecila të kishte punët mirë me fuqinë osmane në rritje dhe me tregun osman, gjithashtu në zgjerim e rritje. Ndodhte që në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin raport përmbledheshin lajme mbi bashkëpunimin e shteteve të ndryshme, siç është një raport i marsit 1484 ku jepeshin të dhëna për një anije të ngarkuar me mallra florentinë drejtuar në Vlorë dhe po ashtu për shkuarjen në Stamboll të sekretarit venedikas Xhovani Dario, i cili theksohej, se ishte po ai që u pat dhënë turqve Shkodrën.<sup>23</sup>

Në dallim nga Venediku që interesohej më shumë për paqe me osmanët se sa për luftë kundër tyre, Spanja si kryeqendra e dinastisë habsburge nuk paraqiste dilema në kundërshtinë e saj ndaj osmanëve. Mirëpo, edhe pse ishte një kundërshtar i vazhdueshëm ndaj osmanëve, ishte njëkohësisht edhe shumë larg për të rrezikuar pozitën osmane, të paktën në Ballkan. Kjo është thelbësore për të kuptuar historinë e përpjekjeve e planeve antiosmane të shqiptarëve dhe dinamikën e tyre. Venediku ishte një fuqi e krishterë kufitare dhe shumë e afërt por e prirur për shtensionim dhe jo tensionim me osmanët. Ndërsa spanjollët ishin të patundur në kundërshtinë dhe prirjen për mbajtjen gjallë të tensionimit me osmanët, por shumë larg për të ndikuar realisht.

Në kundërshtinë mes spanjollëve dhe osmanëve thelbësor ishte fakti që të dy kurorat kishin pretendime perandorake në zonat përkatëse edhe pse monarkia spanjolle ishte një monarki e përbërë, policentrike. Idea e monarkisë universale në rastin spanjoll arrin kulmimin e vet në periudhën

<sup>21</sup> Ivan Cernojeviqi ishte në mosmarrëveshje me venedikasit që nuk i japin ndihmë. *Po aty*, dok. nr. 83, viti 1481.

<sup>22</sup> *Po aty*, dok. nr. 100, 28 shkurt 1484. Nga Raguza lajmërojnë mbretin e Sicilisë për përgatitjet e anijeve në Vlorë dhe për ndihmën që venedikasit u japin turqve. *Po aty*, dok. nr. 102, 8 mars 1484.

<sup>23</sup> *Po aty*, dok. nr. 105, 24 mars 1484.

e Karlit V. Megjithatë, ky pretendim nuk u zhbë edhe pas ndarjes së trashëgimisë së tij mes të birit Felipe dhe të vëllait Fernando. Projekti perandorak u shndërrua në një projekt familjar të habsburgëve të udhëhequr prej monarkëve spanjollë nga Felipe II deri tek Felipe IV.<sup>24</sup>

Në këtë përballje opozitarizmi i brendshëm gjente jo rrallë aleatin më të mirë në kundërshtarin e jashtëm. Kjo ndodhte në të dy krahët. Në krahun osman një nga shembujt më të njohur është ai i sulltanit Xhem, i biri i Mehmetit II që u mund në luftën për pushtet pas vdekjes së të atit nga i vëllai Bajaziti II. Në vitin 1481 ai ishte guvernator i Konjas, kryeqyteti i shtetit selxhuk. Xhemi konsiderohej si trashëgimtari i vërtetë i sulltanatit osman, pasi shihej si më energjik se sa Bajaziti dhe mendohej se vetë Mehmeti II favorizonte Xhemin si pasardhës. Kryeministri u përpoq ta mbante të fshehtë vdekjen e Mehmetit II, me synimin për të lajmëruar Xhemin të parin. Mirëpo, lajmi u zbulua shpejt dhe bejlerbejtë e Rumelisë dhe Anadollit duke qenë në lidhje familjare me Bajazitin e kundërshtuan kryeministrin. Xhemi mblodhi forcat e tij dhe u nis nga Konja drejt Stambollit ku ndodhej Bajaziti, por nuk pati sukses. Historia e kundërshtisë së tij ndaj oborrit sulltanor të të vëllait përfundon në vitin 1499, kur një anije me kufomën e Sulltanit Xhem mbërriti në Vlorë.<sup>25</sup>

Përveç dinamikës së lëvizjeve antiosmane në zonat kufitare të lidhur ngushtë me dinamikën e raporteve ndërkombëtare, tjetër faktor me rëndësi në amortizimin e kryengritjeve ishte edhe praktika e përdorimit të grupeve paraushtarake të krishtera në ushtritë provinciale dhe në sistemin e mbrojtjes dhe patrullimit lokal.<sup>26</sup> Përdorimi i grupeve të tilla paraushtarake, si *martelozët* në Ballkan, daton që herët. Edhe inkuadrimi në shërbimin e ruajtjes së rrugëve e qafave përfshinte shumë prej këtyre popullsisve lokale në një marrëdhënie të veçantë deri diku të privilegjuar me pushtetin qendror ose vendor pavarësisht përkatësisë fetare.

Situata e krijuar në kampin osman synohej të shfrytëzohej nga kundërshtarët. Edhe lëvizjet në Shqipëri nuk mund të shihen pa pasur

<sup>24</sup> José Martínez Millán, *El mito de Faetón o la imagen de la decadencia de la monarquía católica*, Granada: Universidad de Granada, 2011, f. 10.

<sup>25</sup> *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë ...*, IV/I, dok. nr. 306, 11 maj 1499.

<sup>26</sup> Virginia H. Aksan, "Ottoman Ethnographies of Warfare, 1500-1800", in Wayne E. Lee, *Empires and Indigenes. Intercultural Alliance, Imperial Expansion, and Warfare in the Early Modern World*, New York and London: NYU Press, 2011, f. 152-153.

parasysh këtë kundërvënie brendaosmane.<sup>27</sup> Nga një letër e rektorit dhe e këshillit të Raguzës, drejtuar mbretit të Sicilisë e qershorit 1481, thuhej se, pas vdekjes së Mehmetit II, në Shqipëri, shumë krahina ishin në lëvizje të armatosur. Kjo bëri që krerë të njohur si Lekë Dukagjini (Nikollë në një dokument tjetër) dhe Ivan Cernojeviqi të ktheheshin në vendet e tyre.<sup>28</sup> Të njëjtën gjë e kishte bërë edhe Kostantin Muzaka, i cili i referon dukës së Kalabrisë rreth veprimeve të zhvilluara në Shqipëri dhe sidomos në Himarë.<sup>29</sup> Po ashtu edhe rikthimi i Gjon Kastriotit është i lidhur me këtë situatë të anarkisë në oborrin osman pavarësisht se konflikti brenda këtij oborri zgjidhet shpejt në favor të Bajazitit II dhe nuk vonon edhe kundërsulmi osman në Shqipëri.<sup>30</sup>

Që në fillim kryengritjet shqiptare karakterizohen nga një vetëpërmbajtje brenda kufijve etno-socialë. Pavarësisht faktit se në shek. XVIII qendrat e pushtetit osman në trojet shqiptare e monopolizuan si procesin e negocimit politik me qendrën perandorake, ashtu edhe vrullin e pakënaqësisë sociale nuk dëshmohet një agresivitet i tyre ndaj qendrës, siç ndodhi me Mehmet Aliun e Egjiptit që iu kundërvu qendrës perandorake, deri në atë pikë sa që të tentojë zëvendësimin e dinastisë osmane. Shqiptarët dëshmojnë një lloj dualiteti të kushtëzuar gjeografikisht ku brenda territorit etnik synojnë përvetësimin e pushtetit politik, kurse jashtë kësaj hapësire, në këtë zonë “të huaj” priren të jenë besnikë ndaj qendrës perandorake. Prototipi i kryengritësit të tillë është Skënderbeu. Megjithë ngarkesën antiosmane që i ka veshë historiografia, dokumentacioni autentik qoftë ai osman, qoftë ai europian pasqyron mjaftueshëm faktin se në asnjë rast Skënderbeu nuk doli jashtë mburojës gjeografike dhe etnike, duke përjashtuar rastin e fushatës në Pulia ku u ftua nga vetë pushtetarët e zonës. Duket se brenda habitatit etnik e social, për shqiptarët është atdheu malor që shërben si spirancë identitare e politike. Kur dalin jashtë këtij habitatit dhe kur atdheu malor me malet si koordinata jo vetëm gjeografike zhduken nga horizonti, spiranca e sjelljes së tyre politike bëhet tashmë qendra perandorake dhe solidariteti i

<sup>27</sup> Rektori i Raguzës, Biachio Gondola, lajmëron mbretin e Sicilisë për përgatitjet e një flote në Vlorë ku është bërë një grumbullim prej 2 000 kalorësish turq, si edhe për luftimet e zhvilluara në Shqipëri ku kanë qenë thyer dy sanxhakbejlerë. *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë ...*, IV/1, dok. nr. 101, shkurt 1484.

<sup>28</sup> *Po aty*, dok. nr. 74, 2 qershor 1481; dok. nr. 75, 15 qershor 1481.

<sup>29</sup> *Po aty*, dok. nr. 78, para 16 gushtit 1481.

<sup>30</sup> *Po aty*, dok. nr. 81, 15 shtator 1481.

kufizuar etno-social. Në këtë dyjëzim pragmatist dhe pse jo inteligjent mund të gjurmohet edhe një nga arsyet e suksesit të shqiptarëve në administratën dhe ushtrinë perandorake.

Një rast interesant është historia e pinjollit të Arianitëve, që në dokumente del si Komian Arianiti. Historia e tij është interesante në shumë aspekte. Pikësepari ai del në dritën e dokumenteve si pasojë e një kërkesë të bërë nga përfaqësuesit e himariotëve të cilët i kërkojnë Sulltanit që t'u sjellë si sanxhakbe këtë pinjoll të Arianitëve. Një aspekt tjetër, disi më i çuditshëm, i rastit të Arianitit është dëshmia se Sulltani jo vetëm që e shqyrton kërkesën, por edhe ua plotëson dëshirën që të kenë si sundimtar një qeveritar nga gjiri i tyre. Pra, gjendemi përballë një rasti të përfaqësimit politik të iniciuar nga poshtë-lart ose nga niveli lokal. Edhe pse është rast i rrallë që një komunitet lokal kërkon dhe më pas ia del të sjellë si sundimtar dikë që e dëshiron vetë, kjo duket se nuk ishte praktikë e padëgjuar, pasi përndryshe nuk do të kishin kërkuar diçka të tillë.<sup>31</sup> Megjithatë, pasi e kërkojnë Arianitin si qeveritar të tyrin dhe pasi kërkesa u plotësohet, pak kohë më vonë mësojmë se vetë himarjotët e vrasin pinjollin arianitas.<sup>32</sup> Është e vështirë të kuptohen motivet e një vrasjeje të tillë, por nuk mund ta marrim si të mirëqenë se himarjotët që në fillim synonin të vrisnin pinjollin Arianitas duke i ngritur rreng sulltanit. Mund të ndodhemi përballë një zhgënjimi të himarjotëve nga cilësitë, aftësitë apo karakteri i Arianitit, apo përballë një ndryshimi të papritur të situatës ose të ndonjë konfliktualiteti të lindur mes Arianitit dhe himarjotëve. E përforcon këtë joqëllimshëri fakti që ardhja e Arianitit si sanxhakbe ishte bërë duke zëvendësuar Sinan Pashën, i cili pas vrasjes rikthehet sërish në postin e mëparshëm.<sup>33</sup>

Ky rast na ndihmon të shquajmë anën tjetër të ndërveprimit mes shqiptarëve dhe qendrës së pushtetit. Në përgjithësi, aftësia e pushteteve perandorake për të ushtruar ndikimin e tyre varej në masë të madhe nga aftësia për të negociuar dhe ndërvepruar me aktorët e pushtetit lokal. Edhe perceptimi nga qendra e ushtrimit të pushtetit perandorak në raste krizash e thyerjesh apo trazirash e kryengritjesh është vazhdimisht i tillë

<sup>31</sup> Sipas kërkesës së himarjotëve, sulltani u dërgon atyre Komnjan Arianitin me zyrën e sanxhakbeut. *Po aty*, dok. nr. 112, 1484-1485.

<sup>32</sup> Shqiptarët vrasin Komnjan Arianitin. *Po aty*, dok. nr. 119, 17 prill 1486.

<sup>33</sup> Pas vrasjes së Komnjan Arianitit emërohet sërish sanxhakbej i Vlorës Sinan Pasha, i cili zhvillon një ekspeditë në bregdet kundër himariotëve. *Po aty*, dok. nr. 122, 25 nëntor 1486.

që tentohet të kërkohen shkaqet përpara se të trajtohen pasojat. Çdo ndërmarrje e nisur nga qendra perandorake për të riafirmuar pushtetin në raste trazirash e kryengritjesh nis me një hetim mbi abuzimet e përfaqësueve të atij pushteti me të drejtat e banorëve. Në shumë raste, hetime të tilla kanë rezultuar në ndëshkime ndaj përfaqësuesve të pushtetit perandorak të akuzuar për abuzime. Në raste të tjera, janë vetë këta përfaqësues të pushtetit perandorak që i kundërvihen qendrës.

Në këtë aspekt mund të shohim dy nivele të shkëputjes së ndërveprimit qendër-periferi, që për qendrën perandorake konsiderohen si kryengritje. Njëri rast është ai kur banorët ngrënë krye kundër përfaqësuesit të pushtetit perandorak. Rasti tjetër është kur përfaqësuesit e pushtetit perandorak ngrënë krye kundër vetë pushtetit qendror. Nuk është gjithnjë e lehtë të vendoset një kufi ndarës i qartë mes peshës së përfaqësuesve të pushtetit apo banorëve në ffillimin dhe organizimin e këtyre kryengritjeve. Në raste të tilla banorët vendas gjenden në kushte negociimi me të dy palët në konflikt, pasi të dy palët varen nga ndërveprimi dhe mbështetja e banorëve. Qendra perandorake në përballjen me funksionarët kryengritës gjithnjë tenton të bëjë për vete banorët e zonave të prekura. Të njëjtën gjë e bëjnë edhe vetë funksionarët kryengritës. Rasti i përmbushjes së kërkesës së banorëve të Himarës nga Sulltani në rastin e Arianitit, i detyrohet kësaj nevojë të qendrës perandorake për të siguruar qetësinë e himarjotëve në kushtet e një lëvizjeje të përhapur kundërosmane në Shqipëri kur nuk vonon shumë dhe sërish situata ndërlikohet. Ky ndërlikim i vendos venedikasin në një dilemë jo të lehtë. Nga dëshira për të rimarrë primatin e tregtisë me osmanët pas luftës rraskapitëse, Venediku bën çmos që zyrtarët e saj në Shqipëri të jenë të kujdesshëm për të mos lejuar dëmtimin e marrëdhënieve miqësore me osmanët.<sup>34</sup> Nga njëra anë, venedikasin kërkojnë mbajtjen e paqes me osmanët dhe nga ana tjetër, trazirat në prapatokën e Durrësit shkojnë paralelisht me ofensivën osmane përgjatë bregut tjetër të Adriatikut.<sup>35</sup> Kjo politikë shtensionimi dhe fqinjësie të

<sup>34</sup> Venediku urdhëron proveditorin e Kotorrit, podestan e Budues, të Ulqinit, të Tivarit dhe të Durrësit që ta përkrahin paqen ndërmjet nënshtetasve venedikas dhe turq. *Po aty*, dok. nr. 113, 3 janar 1485.

<sup>35</sup> Në Shqipëri pritet të vijë bejlerbeu i Rumelisë kundër kryengritësve të afërsisë së Durrësit. Kryengritësit nuk eksportojnë grurë, as nuk mbjellin më. *Po aty*, dok. nr. 127, 16 prill 1487.

mirë po jepte frytet e parë dhe prania tregtare e venedikasve në portin Vlorës bëhet shqetësim i vazhdueshëm për Senatin.<sup>36</sup>

Për të mbajtur paqen me osmanët dhe për pasojë tregtinë me ta të patruzuar, Venediku nuk hezitonte të ndalonte ata që nxisnin trazira, siç është rasti i Martin Firmanos që u arrestua ndërsa kërkonte të ikte me një anije. Pas arrestimit Firmano vendoset të dalë përpara Senat ku doxha do t'i vinte në dukje dëmin e madh që do t'i sillte Krishtërimin vepra e tij në se do t'i lejohej largimi nga Venediku. Në Senat atij iu hoq vërejtja duke i sqaruar dëmin që ai i sjell krishtërimin dhe ngatërresat që i shkakton Republikës përballë turqve me lëvizjet që ai nxit. Për këtë arsye ai u urdhërua të qëndronte në Venecia dhe të mos largohej prej aty.<sup>37</sup> Ngjashëm edhe disa vite më vonë në vitin 1498, Senati venedikas vendos burgosjen e Gjergj Cernojeviqit, për trazimin e marrëdhënieve të mira me osmanët.<sup>38</sup>

Mirëpo në momentin që Venediku përfshihet në konflikt me osmanët, të gjithë ata që Sinjoria pak kohë më herët ishte përpjekur t'i pengojë, edhe duke i arrestuar e përndjekur i rehabiliton dhe i merr në shërbim të luftës së vet. Kështu në vitin 1499, tashmë është Sinjoria që ia beson Martin Firmanos, drejtimin e lëvizjes së armatosur në Shqipëri. Për këtë në qershor, Këshilli i të Dhjetëve të Venedikut vendos të ftohet Martin Firmano për t'u paraqitur në kolegji që të merret vendimi për ta nisur në Shqipëri ku do të organizojë lëvizjen.<sup>39</sup> Pa vonuar, Firmano nis për në Shqipëri, ndërsa i përndjekuri tjetër i vetëm para një viti, Gjergj Cernojeviqi tregohet i gatshëm të shkojë në Kotorr për të luftuar kundër turqve.<sup>40</sup> Megjithatë edhe në kulmin e përgatitjeve për luftë Venediku kalkulonte hollësisht pasojat e përfshirjes së popullsisë shqiptare në përballjen e saj me osmanët. Kështu, edhe pse lezhjanët shprehin dëshirën të bashkëpunojnë me venedikasit, këta u përgjigjen se nuk ka ardhur koha.<sup>41</sup>

<sup>36</sup> Rreth çështjeve që interesojnë tregtinë e Venedikut me Vlorën. *Po aty*, dok. nr. 136, 9 gusht 1488.

<sup>37</sup> *Po aty*, dok. nr. 196, 197, 6 mars 1495; dok. nr. 199, 8 mars 1495; dok. nr. 200, 9 mars 1495

<sup>38</sup> *Po aty*, dok. nr. 249, 1 korrik 1498.

<sup>39</sup> *Po aty*, dok. nr. 320, 13 qershor 1499; dok. nr. 325, 28 qershor 1499.

<sup>40</sup> *Po aty*, dok. nr. 332, 2 korrik 1499. Tregohet si ka ngjarë helmimi i Martin Firmanos. *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë*, IV/I, dok. nr. 351, 6 gusht 1499.

<sup>41</sup> *Po aty*, dok. nr. 354, 7 gusht 1499.

Diferencimi në status i zonave të ndryshme sillte edhe diferencimin dhe shumëllojshmërinë e qëndrimeve të popullsisë të krishtera apo të islamizuara. Vllahia dhe Moldavia, për shembull, që përkojnë me Rumaninë e sotme mbetën gjithnjë zona të krishtera pasi e kishin negociuar statusin e shtetit tributar ndaj osmanëve që në shek. XV. Deri në shek. XVIII, këto e mbajtën statusin e tyre gjysëm autonom brenda ombrellës politike osmane. Në krye të secilit të këtyre entiteteve politike ishte një Vojsvodë që kishte rolin e administratorit ose guvernatorit.<sup>42</sup>

Kurse, në zonat e tjera të Rumelisë dhe në Shqipëri, evoluimi gradual nga sistemi timariot drejt forcave rajonale të kontraktuara e të mbajtura nga një qeveritar i fuqishëm u ndihmua deri diku edhe prej përdorimit nga osmanët të forcave jo të rregullta, që herët. Aftësia e sundimtarëve lokalë për të rekrutuar forca ushtarake shkoi duke u shtuar derisa nga fundi i shek. XVII një sanxhakbe mund të mbërrinte në një fushatë ushtarake të thirrur nga Porta e Lartë me një forcë të rregullt private prej rreth dyqind vetash dhe me një ose dy mijë forca të rekrutura me kontratë. Pra, zyrtari administrativ kishte marrë edhe funksionet e kontraktuesit ushtarak.<sup>43</sup> Të dhënat zyrtare tregojnë se ky sistem rekrutimi u njëqindfishua për një shekull nga rrethimi i Vjenës më 1683 deri në luftën e parë ruso-osmane të viteve 1768-1774.<sup>44</sup>

Ashtu sikurse mënyrat e ndërveprimit mes zonave e popullsisë të ndryshme me pushtetin qendror edhe mënyrat e kundërshtimit ndryshonin. Në krahasimin ndërmjet lëvizjeve kundërshtuese ndaj pushtetit osman në Rumeli dhe në Moldavi e Vllahi nga njëra anë, dhe atyre të xhelalinjve në Anadoll nga ana tjetër, interpretimi historiografik ka qenë më i ndryshëm se sa dallimi ndërmjet tyre. Revoltat e kundërshtimet në zonat e Ballkanit dhe në principatat rumune janë parë në kuadrin e përpjekjeve kundër zgjedhës osmane dhe si shprehje të aspiratave kombëtare të rumunëve, shqiptarëve etj. Nga ana tjetër, ato të Anadollit edhe pse më problematike dhe më të fuqishme janë parë si shenja të dekadencës së shtetit osman dhe i zhbërjes së rendit publik. Në përgjithësi edhe historianët që shkruajnë për revoltat në Anadoll nuk e

<sup>42</sup> V. Aksan, "Ottoman Ethnographies of Warfare ...", f. 154-155.

<sup>43</sup> Antonis Anastasopoulos, ed., *Provincial Elites in the Ottoman Empire*, Rethymno: University of Crete Press, 2005; Anastasopoulos and Elias Kolovos, eds., *Ottoman Rule and the Balkans, 1760-1850: Conflict. Transformation, Adaptation*, Rethymno: University of Crete Press, 2007.

<sup>44</sup> V. Aksan, "Ottoman Ethnographies of Warfare", f. 156.

hedhin vështrimin në Ballkan e principatat rumune edhe pse bëhet fjalë për kundërshtimin e të njëjtit pushtet.<sup>45</sup>

Në rastin e principatave rumune dhe të xhelalinjve të Anadollit revoltat nuk synonin medoemos shkëputjen nga sistemi i pushtetit osman, por më së shumti një mënyrë të ndryshme negocimi me atë pushtet. Në këtë aspekt, përpjekjet e qeveritarëve lokalë në Ballkan kundër pushtetit qendror ngjasonin me lëvizjen e xhelalinjve por akoma më shumë me ato të vojvodëve rumunë. Ndërsa revoltat e popullsisë kryesisht malore shqiptare apo ballkanike nuk patën asnjëherë ndikim të drejtpërdrejtë në qendrën e pushtetit perandorak. Edhe ndërveprimi mes pushtetit perandorak dhe popullsisë të përfshira në kryengritje mbetej pjesë e skenës lokale dhe për pasojë nuk ndikoi në ndryshimin apo rinegocimin e statusit ligjor të tyre. Ndërkohë që revoltat e xhelalinjve në Anadoll dhe vojvodëve rumunë e ajanëve të Ballkanit shpesh lidheshin me rivalitetet në Portën e Lartë, revoltat e popullsisë kufitare malore lidheshin me mbështetjen e fuqive të huaja kundërshtarë të Portës së Lartë.<sup>46</sup>

Një nga pikëpyetjet në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me përballjen dhe kundërvënien e shqiptarëve ndaj sundimit politik osman është vendosja e kësaj përballjeje në koordinata të qarta sociale. Për këtë është e nevojshme që në asnjë moment të mos e humbasim nga shikimi kohën dhe kontekstin kur ndodhën ngjarjet dhe proceset që trajtohen. Që herët përballemi me fenomenin e luftëtarëve shqiptarë të cilët me armë në dorë jetojnë dhe mbajnë familjet e veta. Prania e tyre është e ndjeshme si në kuadër të pushtetit osman, ashtu edhe në atë të vendeve të tjera myslimane por edhe në kuadër të shteteve europiane. Jo rrallë kapërcimi nga një fushatë në tjetrën, nga një shtet në tjetrin bëhet nga të njëjtët personazhe. Kështu, në shkurt 1493 merret vesh se dy drishtjanë që kishin qenë të inkuadruar në ushtrinë osmane kishin dezertuar dhe ishin

<sup>45</sup> Michał Wasiucionek, "Celali Voievodes? The strategies of rebellion and the transfer of political culture between the Ottoman and Moldavian–Wallachian political elites in the 17th century," paper at *21st Symposium of the Comite International des Etudes pre-Ottomanes et Ottomanes*, Budapest, 7–11 October 2014.

<sup>46</sup> Në konfliktin midis rivalëve rumunë, Vasile Lupu kishte mbështetjen Tabaniyassı Mehmed Pashës kurse kundërshtari i tij atë të Silahdar Mustafa Pashës. Constantin C. Giurescu, "Uciderea veziurului Mohamed Tabani Buiuc, sprijinătorullui Vasile Lupu," *Revista istorică* 12, no. 3, Bukuresht: 1926, f. 101; Miron Costin, *Letopisețul Țării Moldovei dela Aron Vodăincoace*, ed. P.P Panaitescu, Bucharest: Fundața Regală pentru Literaturăși Artă, 1943, f. 102.



rekrutuar si stratiotë nga Venediku.<sup>47</sup> Prandaj nuk është e lehtë të interpretohet dëshmia e vitit 1499 se Gjon Muzaka, djali i Muzak Arianitit, po bëhej gati të dilte në Shqipëri me 300 kalorës.<sup>48</sup> A ishte ky rikthim në Shqipëri me synim politik të caktuar, për të rimarrë tokat e familjes së vet, apo ishte në kuadër të marrdhënieve më të gjera ndërkombëtare, konkretisht të konfliktit veneto-osman të rinisur pas dy dekadash paqe. Kjo pasi, këta pinjoj familjesh shqiptare në Europë kishin arritur të integrohen me njëfarë suksesi në strukturat ushtarake të shteteve të ndryshme europiane dhe jo thjesht si forca mercenare.<sup>49</sup> Po aq interesant është fakti që shtete të ndryshme kishin agjenda të ndryshme të cilat duke mos u përputhur sillnin edhe ndryshime të shpejta e kontradiktore qëndrimesh e situatash. Kështu në vitin 1495, kur francezët po përgatishnin zbarkimin e tyre në Itali që e justifikonin me pretendimin se synonin ta përdornin Italinë thjesht si rrugëkalim drejt një sulmi kundër osmanëve, ipeshkvi i Durrësit, Martin Firmano përpiqet të organizojë një ekspeditë në Shqipëri në suazën e zbarkimit frëng në Ballkan. Për këtë qëllim takohet me princërit shqiptarë në Itali. Ndër ta është edhe Konstantin Arianiti, në bashkëpunim me të cilin organizon një ekspeditë që dështon nga ndërhyrja armiqësore e venedikasve të cilët arrestojnë Martinin,<sup>50</sup> i cili ia kishte dalë të vinte në lëvizje një numër kryengritësish, të cilët thuhet se e kanë dërguar ambasador të tyre pranë mbretit të Francës, Karlit VIII.<sup>51</sup>

Tensionit në rritje midis Perandorisë Osmane dhe Perandorisë Habsburge të Karlit V iu shtua, elementi i tretë, që për më tepër veproi kundër spanjollëve, pra Monarkia Franceze që me mbështetjen e saj të vazhdueshme për iniciativat osmane e ndërlikoi së tepërmi hapësirën e manovrimit politik të perandorit. Franca ishte vazhdimisht një nga rivalët politikë të Karlit V gjatë gjithë mbretërimit të tij, së bashku me osmanët

<sup>47</sup> Këshilli i të Dhjetëve i Republikës së Venedikut vendos të rekrutojë si stratiotë Gjergj Golemin nga Drishti, që ka qenë në shërbim të Daut Pashës, dhe Progran Balzakun, edhe ky drishtjan, që ka qenë në shërbim të Ali Pashës. Që të dy këta kanë dezertuar gjatë ekspeditës së fundit turke kundër Himarës. *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë ...*, IV/1, dok. 175, 27 shkurt 1493.

<sup>48</sup> *Po aty*, dok. 372, 10 shtator 1499.

<sup>49</sup> Konstantin Arianiti për shembull, emërohet vikar i përgjithshëm i perandorit Maksimilian në Itali. *Po aty*, dok. 207, 12 qershor 1496.

<sup>50</sup> *Po aty*, dok. 192. 1494/1495. Dështimi i ekspeditës së Firmanos sepse venedikasit ndërhyjnë për ta penguar. *Po aty*, dok. 194, 4-7 mars 1495.

<sup>51</sup> *Po aty*, 28 shkurt 1495.

dhe protestantët. Ky qëndrim i francezëve bëri që në vitin 1535, pas ekspeditës së Karlit V kundër Tunizisë, francezët dhe osmanët të nënshkruanin një aleancë, e cila vazhdoi edhe me pasardhësin e tij në fronin francez, Henry II dhe mbeti efektive deri në shek. XVII. Momenti më domethënës i kësaj aleance franko-osmane ishte në vitin 1543, kur osmanët dhe francezët bashkuan forcat e tyre ushtarake dhe pushtuan bashkërisht Nicën e mbajtur nga spanjollët.

Në hartimin e projekteve mbietnike një rol të rëndësishëm luante afërsia krahinore, sociale dhe fetare. Kjo lehtësohej edhe nga fakti se organizatorët dhe agjitorët ishin njerëz me kontakte e lidhje ndëretnike e ndërkrainore. Rast i tillë është ai i vitit 1614 kur organizohen mbledhje krerësh të krahinave të Shqipërisë Veriperëndimore si edhe serbë e malazezë, duke kulmuar në kuvendin e Kuçit. Pavarësisht karakterit ndërkrainor e ndëretnik, megjithatë, lidhjet dhe përfaqësimin kryesor e morën në dorë, shqiptari Gjon Renësi dhe aventurieri Sulltan Jahja.<sup>52</sup>

Gjon Renësi ia doli të bindë Dukën e Parmës që ta mbështesë me mjete financiare në ecejaket e tij nëpër Itali dhe ndërmjet dy brigjeve të Adriatikut. Renësi u ftua të hyjë në Kuvend duke i kërkuar që të këtë mirësinë të mos bëjë ashtu siç kanë bërë princa të tjerë, të cilët “me premtimet e tyre bënë të ngrihemi në kryengritje me shpenzime tepër të mëdha, duke na munguar ndihma dhe përkrahja që na kishin premtuar, e kemi pësuar me jetë edhe me nderë dhe mall.”<sup>53</sup> Edhe Duka i Parmës e kuptoi se po mbështeste ca aventurierë që shpenzonin paratë e dhëna prej tij nëpër Itali. Në vend që të shkonte në Shqipëri dhe t’i dërgonte porosinë e Dukës krerëve e të hynte në marrëveshje, Renësi kishte shkuar në Mantovë, ku në të njëjtën kohë arriti edhe Jahjai mbas kthimit nga Gadishulli Ballkanik. Edhe kuvendarët nga ana e tyre mbetën të mashtruar pavarësisht shpresave që kishin se Gjon Renësi do të shkonte tek Papa për të njoftuar për mënyrën se çka ishte vendosur në Kuvendin për çlirimin e popujve të Ballkanit nga sunduesit osman.<sup>54</sup> Projektet e hartuara kryesisht nga elementë aventurierë vuanin nga pasaktësia e të

<sup>52</sup> *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë ...*, vëll. III. dok. nr. 199, 20 prill 1616.

<sup>53</sup> *Po aty*, dok. nr. 188, f. 292. Gjon Renes, i dërguari i veçantë i Kuvendit pranë dukës të Parmës.

<sup>54</sup> François Lenormant, *Turcs et Monténégrins*, Paris: Librairie Académique, 1866, f. 331.

dhënave, nga zmadhimi i efekteve të pritshme dhe lehtësia gati e pabesueshme e realizimit të pretenduar.

Një rast tjetër është ai agjentëve të cilët shpesh ngatërrohen me çështjet e kryengritjeve dhe projekteve për kryengritje të popullsisë lokale. Fakti që pothuajse të gjithë agjentët apo spiunët që dokumentohen në këtë periudhë janë të lidhur me shërbimet agjenturore spanjolle shpjegon edhe thelbin e tyre. Venedikasit nuk shërbeheshin nga spiunë të mirëfilltë për shkak se kishin përfaqësim diplomatik në rang ambasadori në Stamboll dhe që kryente funksionin e informimit.<sup>55</sup> Ngjashëm edhe Papati kishte misionarë e klerikë të cilët ishin të njohur e të pranuar nga autoritetet osmane dhe infomacionet që ata përcillnin ishin pjesë e punës së tyre. Pra, agjentët në terren kompensojnë mungesën e përfaqësisë diplomatike për spanjollët. Habsburgët spanjollë gjetën tek popullsitë e krishtera të Ballkanit një aleat të natyrshëm që mund të nxitej për kryengritje kundër osmanëve. Përpara së gjithash tek këto popullsi gjetën një derë të hapur për dërgimin, mbështetjen e strehimin e spiunëve habsburgë. Rasti i shqiptarit që përmendet me emrin Duli është ilustrues. Duli ishte një shqiptar me pozitë të lartë sociale, si një nga krerët e fshatrave në afërsi të Bastias në bregun shqiptar përballë Korfuzit venedikas. Statusi i tij si person me pozitë në administratën vendore osmane dhe njëkohësisht lidhjet që kishte me territorin venedikas të Korfuzit, i mundësuan të bëhej një nga mbështetësit kryesorë të agjentëve spanjollë që nën veshje e pretendime të ndryshme udhëtonin nga territoret spanjolle drejt Stambollit dhe anasjelltas që prej vitit 1564. Rëndësia e mbështetjes së tij bëhej edhe më e madhe po të kemi parasysh se osmanët kishin agjentët e tyre që vëzhgonin me kujdes lëvizjet e dyshimta të udhëtarëve e tregtarëve që mbërrinin në bregun shqiptar nga Korfuzi.<sup>56</sup> Natyrisht që këto shërbime jepeshin kundrejt pagesave të dakorduara sipas rëndësisë së punës dhe aktivitetit të secilit, por edhe sipas rangut.<sup>57</sup> Me rëndësi në këtë kuadër është mungesa e besimit reciprok ndërmjet spiunëve vendas dhe autoriteteve spanjolle që mbështeteshin tek ata për informacione e ndihmë. Sipas Garnicer dhe Marcos, spiunët spanjollë në

<sup>55</sup> « Carta de Juan Andrea Doria, príncipe de Melfi, a Felipe III, rey de España, sobre proyectos que propone contra el Turco: fomento de levantamientos en Morea y operaciones en Albania ». *Archivo General de Simancas* (më tej: AGS) Consejo de Estado. Est. Leg. 1431-69, 13 janar 1601.

<sup>56</sup> *Po aty*, E 487, Giralomo Combi Albanes, 20 prill 1577.

<sup>57</sup> *Po aty*, E 486, Madrid, 25 mars 1568.

Angli e Francë paguheshin më shumë sesa ata që vepronin në territoret osmane sepse habsburgët nuk u zinin besë.<sup>58</sup> Duhet pasur parasysh se mungesa e një përfaqësimi diplomatik spanjoll në Stamboll vetvetiu krijonte problem edhe me përzgjedhjen e njerëzve të besueshëm dhe të aftë.<sup>59</sup>

### *S u m m a r y*

#### THE ANTI-OTTOMAN DESIGNS OF 16<sup>TH</sup> AND 17<sup>TH</sup> CENTURY AMIDST FANTASY, INTEREST AND REALITY

The projects of different nationalities for liberation from Ottoman rule cannot be perceived separated from the measures taken by the imperial government against potential rebellions and uprisings. For the Ottomans, as for every political rule, self-preservation and continuity were of major concern. The attempts to undermine the stability of the central power were dealt with great attention. The challenge to Ottoman rule came at times from the imperial state structures as well as from within the Ottoman ruling class itself. As in other similar cases, the rule's structure and negotiation in Albanian territories evolved through the centuries we are referring to in this study, due to several factors. Firstly, the evolvement of the central power contributed to such a change; secondly, the dynamics of social development in Albanian territories; and thirdly, the shift in international balance of power. Thus, the dynamics and frequency of anti-Ottoman endeavours in general was closely related with the international situation and its influence in the Albanian territories. The uncertainty to rely on a firm support from the Spanish or the Venetians, and later on from the Austrians and Russians, made the local population aware that

<sup>58</sup> Carlos Carnicer, Javier Marcos, *Espías de Felipe II: los servicios secretos del imperio español*, Madrid: La Esfera de los Libros, 2005, f. 372.

<sup>59</sup> Në mesin e agjentëve spanjollë në Adriatik shquhet në gjysmën e dytë të shek. XVI, Jerónimo Bucchia, i cili del në dokumente që në vitin 1560. Ky ulqinak ia doli të krijojë rrjetin e vet të informimit me veprimtari të shtrirë në pikat kyçe të sistemit adriatikas të transportit e komunikimit. Krijoi një rrjet të tërë informatorësh në Raguzë, Kotorr, Tivar, Venecia, Vlorë etj. María José Bertomeu *Masiá*, Antoine Perrenot de Granvelle, *Cartas de un espía de Carlos V: la correspondencia de Jerónimo Bucchia*, Universitat de València: 2006, f. 16; AGS, E 1056, fol. 56 (28 korrik 1563).

---

foreign backing was temporary and shaky. This was one of the reasons that made the secular and religious leaders to act cautiously and avoid becoming part of adventurous local enterprises or ambiguous foreign projects. In contrast to Venice which was interested in maintaining peace with the Ottomans rather than fighting them, Spain as the centre of the Habsburg dynasty, was clearly positioned as the Ottomans' foe. However, although a perpetual adversary of the Ottomans, Spain was situated very far away to threaten the Ottoman rule, at least in the Balkans. This is a central element in understanding the history and dynamics of the Albanians' anti-Ottoman attempts and plans for liberation.

